

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE, SHOQËRISË

“NONA” SHPK TIRANË

Për ushtrimin financiar të mbyllur më 31 Dhjetor 2022

TË PËRGJITHËSHME DHE POLITIKAT KONTABEL

Shoqëria “NONA” SHPK, u regjistrua si biznes në datë 04/07/2019 me objekt veprimtarie: Bar kafe, restorant, si dhe cdo veprimtari tjetër ekonomike që do të konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme për realizimin e qëllimit të shoqërisë e që nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar. Kjo shoqëri është regjistruar pranë organeve tatimore me NIPT: L81904012A.

MBI POLITIKAT KRYESORE TË KONTABILITETIT

Pasqyrat financiare më 31 Dhjetor 2022 janë përgatitur në përputhje me kërkesat e Ligjit 9901 të datës 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare” si dhe të ligjit 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin e pasqyrat financiare”

Kontabiliteti i shoqërisë “NONA” SHPK, është i organizuar rregullisht, i mbështetur mbi sistemin manual të mbajtjes të kontabilitetit, si dhe ata të informatizuar të cilat mundësojnë jo vetëm regjistrimin e të dhënave por dhe marrjen e informacionit, respekton të gjitha kërkesat e Planit Kontabël, ligjin mbi Kontabilitetin dhe kërkesat e tjera ligjore. Llogaritë e ushtrimit financiar të vitit 2022 janë hartuar me hipotezën e vijueshmërisë dhe janë zbatuar vlerësimet e parashikuara në këtë situatë.

Monedha në të cilën shprehen të gjitha pasqyrat financiare është leku shqiptar pa bërë rumbullakime.

VLERËSIMI I KONTROLLIT TË BRENDSHËM

Efikasiteti i kontrollit të brendshëm është i lidhur me sigurimin e mbrojtjes së pasurisë nga cdo lloj dëmtimi e shpërdorimi dhe në të njëjtën kohë të sigurojë besnikërinë e informacionit administrativ, kontabël e financiar duke qenë i besueshëm nga përdoruesit.

Vendimarrja në lidhje me problemin e kontrollit të brendshëm lidhet edhe me përgjegjësinë e zbatimit të objekteve dhe parimeve të kontrollit duke filluar nga përdoruesit.

Vendimarrja në lidhje me problemin e kontrollit të brendshëm lidhet edhe me përgjegjësinë e zbatimit të objekteve dhe parimeve të kontrollit duke filluar nga ndarja e punës, verifikimet dhe deri tek informimet, veprime këto që përgjithësisht në Entitet janë realizuar.

SHËNIME MBI ZËRAT E LLOGARIVE NË PASQYRAT FINANCIARE

AKTIVI

AKTIVET MONETARE

Në këtë pozicion të bilancit janë pasqyruar, aktivet monetare në vlerën **346,585 leke**, përcaktuar në llogaritë në arkë dhe në bankë. Ka vijueshmëri në regjistrimin e dokumentave, për sa i takon datave dhe ka dokumenta justifikuese për veprimet e kryera.

AKTIVE TË TJERA FINANCIARE AFATSHKURTËRA

Kërkesa të arkëtueshme në vlerën **8,468,592 lekë** ku përfshihen detyrimet e klientëve, llogaria 411 "Kliente për mallra, produkte e shërbime" dhe kërkesa të tjera të arkëtueshme në vlerën **2,278,843 lekë** ku përfshihet llogaria 4461 "Detyrime për taksa doganore", llog 418 "Parapagime", llogaria 4455 "TVSH e zbritshme"

INVENTARI

Inventari për vlerën **171,047,590 lekë**, përfshihet llogaria 351 "Mallra grupi I", llogaria 311 "Materiale të para", llogaria 327 "Inventar i imet"

SHPENZIME TË SHTYRA

Shpenzime të shtyra në vlerën **1,046,879 lekë** nga llogaria 486 "Shpenzime të periudhave të ardhme".

AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Aktive të tjera afatgjata materiale me vlerë kontabël për vlerën **613,347,223 lekë**, ku përfshihen : llogaria 2182 "Pajisje informative", llogaria 2188 "Te tjera", 2134 "Makineri , pajisje pune" llogaria 2818 "Për te tjera AA materiale", llog 2181 "Mobilje dhe pajisje zyre", llog 2183 "Telefona, celulare", llog 2811 "Pajisje Fiskale", llog 28111 "Kompjuter + Monitor", llog 28113 "Për te tjera AA materiale" etj.

PASIVI

HUATË E PARAPAGIMEVE

Për vitin ushtrimor 2022 detyrimet në total janë në vlerën **515,790,384 lekë** që në mënyrë analitike janë si më poshtë :

Detyrimet afatshkurtra me vlerë totale **304,972,383 lekë**, ku përfshihen:

Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit, llogaria 401 "Llogari të pagueshme" në vlerën **275,362,453 leke**

Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 8,054,271 lekë, ku përfshihet: llogaria 421 "Paga dhe shpërblime" dhe llogaria 431 "Sigurime shoqërore dhe shendetesore"

Të pagueshme për detyrimet tatimore në vlerën 13,471,666 lekë, ku përfshihet llogaria 442 "Tatim mbi të ardhurat personale" llogaria 449 "Tatimi në burim", llogaria 444 "Tatim mbi fitim"

Detyrime ndaj institucioneve të kredise në vlerën 8,063,994 leke ku përfshihet llogaria 460 "Leasing"

Detyrime afatgjata në vlerën 210,818,001 leke ku përfshihet llogaria kredia bankare

KAPITALI

Gjendja e llogarive të Kapitalit dhe Rezervave të Shoqërisë në përfundim të periudhës është në vlerën **311,796,134 leke**, përfshin llog 101 "Kapital i vetë" në vlerën **225,100,000 leke**, fitimi i pashpërndarë në vlerën **71,854,005 lekë** dhe Fitimi i vitit ushtrimor 2022, marrë nga PASH, me vlerë **14,842,129 leke**.

PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

Për vitin 2022 Shoqëria "NONA" SHPK ka realizuar shpenzime në masën **1,303,035,363 lekë** ngaveprimtaria e shfrytëzimit. Shpenzimet janë si më poshtë:

Mallra lendet e para dhe sherbime 655,781,941 lekë ku përfshihen llogaria 605 "Blerje /shpenz të mallrash", llogaria 6035 "Bl.energji,avull,uje", llog 602 "Blerje/shpenzime të materialeve të tjera", llog 6032 "Ndrysh,gjend,mater,të tjera"

Shpenzime të tjera nga veprimtaria e shfrytëzimit 337,259,735 lekë ku përfshihen: llogaria 604" Bl.energji, avull,uje", llogaria 626 "Shpz.postare e telekom"; llogaria 638 "Tatime të tjera", llogaria 657 "Gjoha dhe dëmshpërblime", llogaria 613 "Qira", llogaria 615 "Mirembajtje dhe riparime", llogaria 617 "Studime dhe kërkime", llogaria 608 "Blerje/ shpenzime të tjera", llogaria 634 "Taksa dhe tarifa vendore", llogaria 618 "Shpenzime të marra", llogaria 6241 "Shpenzime marketingu", llog 6261 "Shpenzime interneti"etj.

Paga në vlerën 231,468,864 lekë ku përfshihet 641 "Pagat dhe shpërblimet e personelit"

Shpenzimet e sigurimeve shoqërore për 65,045,167 lekë ku përfshihet llog 644 " Sigurimet shoqërore dhe shendetësore".

Shpenzimet financiare në vlerën 224,412 leke përfshijnë:

Llogaria 628 "Sherbime bankare", llogaria 667 " Shpenzime për interesa", llogaria 668 "Shpenzime financiare të tjera", llog 769 "Fitimi nga kursi i kembimit"

Shpenzime tatim mbi fitimin në vlerën 13,704,068 leke nga llogaria "Tatime mbi fitimet".

MBI TË ARDHURAT

Shoqëria ka realizuar të ardhura në masën **1,317,877,491 lekë** nga veprimtaria e shfrytëzimit ku përfshihet:

Llogaria 704 " Shitje e punimeve dhe e sherbimeve" ,llogaria 705 "Shitje mallrash",

PËRLOGARITJA E TATIM FITIMIT

FITIM/(HUMBJA) E USHTRIMIT	28,546,196
SHPENZIME TE PANJOHURA	
TATIM FITIMI (15%).	13,704,068
FITIM/(HUMBJA) TATIMORE	14,842,128

PASQYRA E FLUKSIT TË PARAVE-Metoda Indirekte

Eshtë ndërtuar nga ana e jonë në përputhje me standartet kombëtare të kontabilitetit, bazuar në levizjet e mjeteve monetare të shoqërisë sipas kërkesave që ka vetë pasqyra dhe në perfundim rezulton:

Mjete monetare në fillim **9,594** lekë

Mjete monetare në fund të periudhës **346,580** lekë

Rritja/rrenja neto e mjeteve monetare **336,987** lekë

Pra, ka përputhje të plote të pasqyrës të fluksit monetar dhe gjendjes të aktiveve monetare të vendosura në aktiv të bilancit.

SHËNIME TË TJERA SHPJEGUESE

Ngjarje të tjera të ndodhura pas datës të bilancit për të cilat bëhen rregullime apo ngjarje të ndodhura pas datës të bilancit që nuk bëhen rregullime, nuk ka.

Duke patur parasysh shënimet e mësipërme, paraqitim të gjitha aspektet, të gjendjes financiare të shoqërisë deri më 31.12.2022.

Tiranë , më 30.03.2023

Ekonomisti

Loela Sterju
Loela

Administratori

Ervin Manushi

Ervin Manushi

